



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.534/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Arbenita Murseli Haxholli, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 27.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i palejueshëm apeli Anr.534/2021 i datës 25.08.2021, i parashtruar nga Arbenita Murseli Haxholli, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje si kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 17 Tetor 2021.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit Arbenita Murseli Haxholli, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik AKR, me datën 25.08.2021 ka paraqitur një apel në PZAP, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se KQZ-ja, e ka larguar nga lista e kandidateve për kuvendin Komunal, në mënyrë të padrejtë. E njëjta ka theksuar se lënda e cila ka shërbyer për ta hequr nga lista ka të bëjë me aktgjykimin e saj të plotfuqishëm në nëntor të vitit 2019, sepse deklarimin e pasurisë e ka bërë vetëm 4 ditë me vonesë dhe kjo i ka ndodh për arsye shumë të ndjeshme. Në vazhdim pretenduesja e apelit theksoi se gjatë muajit mars të vitit 2019 kur ishte afati për të deklaruar pasurinë ishte në muajin e tretë të shtatzënisë. Më tutje ka theksuar se gjatë shtatzënisë ka pasur komplikime të shumta sidomos në muajin e tretë të shtatzënisë dhe iu është dashur të qëndroj e shtrirë dhe se gjatë asaj kohe e njëjta nuk e ka parë emailin i cili iu është bërë për deklarimin e pasurisë. Në vazhdim të apelit theksoi se pas telefonatës nga zyrtarja nga komuna lidhur me deklarimin e pasurisë e ka bërë menjëherë pa hezituuar, por lënda e saj ishte dorzuar në prokurori me të cilën kishte pranuar thirrjen që të merret në pyetje për lëndën e saj, për mosdeklarim të pasurisë. Pas marrjes në pyetje nga prokuroria parashtruesja e apelit theksoi se nuk e ka pranuar fajsinë në prokurori dhe në muajin gusht i ka lindur fëmija me shëndet të mirë.

Parashtruesja e apelit shton se pas katër jave të lindjes, foshnja kishte probleme shëndetësore me të cilën dhjetë ditë ka qëndruar në spital duke përdorur terapi të rëndë nën kujdesin intenziv dhe se kujdesi ka vazhduar edhe pas daljes nga spitali me ç'rast gjendja shëndetësore iu kishte vështirësuar edhe më shumë

Gjatë kësaj periudhe të njëjtën e kishte telefonuar gjykata që të paraqitet në seancë lidhur me deklarimin e pasurisë dhe se në atë gjendje të mërziur kishte marrë pjesë në seancë dhe kishte pranuar fajsinë, siç thekson pa qenë fajtorë, me qëllim që të përfundojnë procedurat gjyqësore sa më shpejtë sepse donte të lirohet nga ky obligim ndaj gjykatës dhe të merret me shëndetin e vajzës.

Pretenduesja e apelit thekson se aktgjykimi me të cilën është shpallur fajtorë po i sjell probleme për kandidimin e saj në Zgjedhjet Lokale 2021.

Kërkon nga PZAP-i, që ti ketë parasysh arsyet e saja personale me të cilin e kishte patjetër të pranojë fajësinë vetëm për shkak fëmiut me të cilën vetëm një prind do ta kuptonte dhe shpreson se do ta ketë parasysh apelin e saj dhe do të ia bëjë të mundur kandidimin e saj në këto zgjedhje, siç thotë se nganjëherë ana humane duhet të vihet para asaj profesionale.

Lidhur me deklarimin e pasurisë thekson se mund të gjendet dhe se kanë një jetë mesatare, paga mesatare, dhe se këto janë arsyet e mos deklarimit të pasurisë me kohë të caktuar.

Apelit ka bashkangjitur si dëshmi, raportet mjekësore të saj, kërkesën për shlyerje nga evidenca e personave të dënuar, Aktgjykimin nga Gjykata Themelore-Prishtinë me numrin e lëndës P.nr.2229-19 dhe Urdhër pagesën me fletëtransferin.

Me datë 25.08.2021 PZAP, i ka paraqitur KQZ-së kërkesë për përgjigje duke kërkuar që të paraqesë përgjigje në ankesë deri me datë 25.08.2021 ora 16:00.

KQZ-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast Arbenita Murseli Haxholli, kandidatë për asamble komunale në Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) nga të dhënat e pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në listën e Kandidatëve të subjektit politik AKR rezulton të jetë shpallur fajtor për vepër penale me vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigjen e parashtruar ka sqaruar se subjektit politik AKR për kandidaten Arbenita Murseli Haxholli i është dhënë afat për të dërguar zëvendësimin deri më 25 gusht në ora 16:00, në zyrë.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, konstaton se pretendimet ankimore të parashtruesës të apelit, Arbenita Murseli Haxholli, se është larguar nga lista e kandidatëve për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja ende nuk ka marrë vendim lidhur me certifikimin apo mos certifikimin e kandidateve të subjekteve politike, ashtu siç del edhe nga vet përgjigja në ankesë e KQZ-së e parashtruar më datën 25.08.2021. Kërkesa e ZRPPC-se ju është drejtuar subjekteve politike për zëvendësim të kandidateve të tyre, dhe në këtë rast, nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendimi lidhur me certifikimin apo refuzimin e kandidatëve të caktuar të subjekteve politike.

Kërkesa e ZRPPC-së, drejtuar subjekteve politike për zëvendësim të kandidateve të tyre nuk është vendim i KQZ-së, ndaj të cilit lejohet apeli, por është një kërkesë nga ZRPPC-ja, në lidhje me rastin në fjalë, ku subjektit është njoftuar se kandidatja në listën zgjedhore pas verifikimit nga ana e KGJK-së nuk është i përshtatshëm sipas Ligjit, dhe subjekti ka mundësi ta zëvendësoj me ndonjë kandidat tjetër brenda një periudhe të caktuar para se të rekomandohet nga zyra në fjalë certifikimi apo mos certifikimi i listës së plotë të kandidateve. Pra faza kur është parashtruar apeli është e parakohshme sepse nuk kemi vendimmarrje të KQZ-se për certifikim të subjektit dhe listës së tyre, por kemi vetëm zëvendësim nga subjekti të cilit i përket apelu, dhe se subjekti nuk është i obligueshëm të beje zëvendësimin e kandidatit nëse vlerëson se të gjithë kandidatët janë të përshtatshëm konform nenit 29 të LZP-së.

Meqenëse në rastin konkret nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit të vendosë lidhur me kërkesat e ZRPPC-së, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërshënuar.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk çenon të drejtën e ankuesit që pas certifikimit apo kundërshtimit për certifikim të kandidateve të subjekteve politike nga KQZ-ja, ta paraqes sërish ankesë, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar, edhe pas certifikimit nga KQZ-ja.

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është e palejuar. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 534/2021 më datën 27.08.2021.



Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.